



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

IV.

Titulli i punës: Pastruese një (1) pozitë në Teatrin Kombëtar të Kosovës

Kategoria funksionale-Paga: 349€

Numri i referencës: 74/2017

I përgjigjet: Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës

Vendi: Prishtinë

Lloji i kontratës: "Marrëveshje për shërbime të veçanta" (kohëzgjatje 6 muaj)

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Kryen punët e mirëmbajtjes së pastërtisë brenda dhe jashtë objektit të Teatrit Kombëtar të Kosovës;
2. Kujdeset që pastërtia në objektin e Teatrit ,të jetë gjithmonë në nivel;
3. Bën pastrimin dhe larjen e dritareve,dyshemesë,inventarit,paisjeve tjera nëpër zyre dhe ambiente tjera të Teatrit;
4. Largon gjërat pa vlerë;
5. Përgjigjet për mjetet e punës me të cilat ngarkohet për kryerjen e punës së vet;
6. Kryen edhe detyra tjera sipas rekomandimeve të Drejtorit.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës;
2. Përvoja e mëparshme në fushë të përafërt është përparësi;
3. Të jetë i sigurtë që është në gjendje të marr përsipër,të gjitha detyrat e specifikuara;
4. Të jetë energjik,të ketë shkathtësi të mira ndërnjerzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës;
5. Të jetë i përgjigjshëm dhe të respektoj orarin e punës;
6. Të ketë përgatitje shkollore fillore apo të mesme.

Procedurat e konkurimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur tetë (8) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 29.11.2017

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës,me pullë postare,në ditën e fundit të shpalljes,konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës,Rinisë dhe Sportit, Sheshi " Nëna Terezë " nr.44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038/211449 (apo web-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>) Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohen në nenin 11,paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës'' Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.